



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 88 /2021
Datë: 25.05.2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 371 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 3/2013, 31.01.2013), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 15/2017, 11.05.2017), në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullorës (QRK) – Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021) si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, Ministria e Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

1. PRANOHET kërkesa e z. Adnan Isufi, Kryesues i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, PËRJASHTOHET Kryesuesi dhe Anëtarët e Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, nga vendosja në lëndën DPL-09/2021.
2. AUTORIZOHET zëvendës Kryesuesi dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, të emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 33/2020 dt. 15.04.2020, për vendosje në lëndën DPL-09/2021.

Arsyetim

Me kërkesën e datës 21.05.2021 komisioni ka kërkuar që lënda me nr. DPL-09/2021 që është caktuar të shqyrtohet nga Komisioni Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat i përberë nga z. Adnan Isufi, kryesues, znj. Djellza Hoxha, anëtare dhe z. Rushit Hoxha anëtar, të shqyrtohet nga zëvendës anëtarët e Komisionit sipas vendimit nr. 33/2020 dt. 15.04.2020, pasi nga Përmbartuesi Privat z. Flamur Bogaj i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (palë në procedurë) është ushtruar Kallzim Penal ndaj Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor në përbërjen e lartëcekur me pretendimin së të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit zyrtar dhe Keqepërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar, vepra këto të denueshme me dispozitat e Kodit Penal.

Ministrja e Drejtësisë pasi shqyrtoj kërkesën bëri shikimin në shkresat e lëndës dhe duke i analizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbaremore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjeti se kërkesa është e bazuar.

Ministrja vlerëson se përjashtimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor në lidhje me këtë rast do të ndikoj pozitivisht në rritjen e besimit të palët për objektivitetin e Komisionit Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

 **Albulena Haxhiu**
[Signature]
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Kabinetit të Ministres*
- *Përmbaruesit Privat,*
- *Departamentit për Profesione të Lira,*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*